



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE:
5. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_87_05_08 të datës 21 maj 2008
6. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 23 qershor 2008
7. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit Aziz Cenaj, (shifra e konsumatorit DPR – 1952) nga Prishtina, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me 18.09.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Departamenti për Konsumatorë të datës 17 shtator 2007 me numër reference DPR – CO1- 01, lidhur me faljen e borxhit.
2. Me datë 16 gusht 2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK Sh.A – Departamenti për Konsumatorë lidhur me mundësinë e pagesës së borxhit të energjisë elektrike në këste.
Provë: Dëftesa e ankesës së konsumatorit në KEK.
3. Me datë 17 shtator 2007 KEK – Departamenti për konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se borxhi deri në muajin 7/2002 ju është shlyer me librezë sociale në shumë prej 1,070.90 €
Provë: Përgjigja e KEK Sh.A e datës 17 shtator 2007
4. Konsumatori me datë 25 maj 2006 ka nxjerrë një vërtetim nga Qendra për punë sociale në Prishtinë në të cilin vërtetim theksohet se konsumatori i lartpërmendur ka qenë shfrytëzuesi i ndihmës sociale prej 30 tetor 2000 e deri më 06 dhjetor 2004.
Provë: Vërtetim nga qendra për punë sociale



5. Konsumatori ka nxjerrë me datë 23 maj 2006 edhe një dëshmi nga shoqata e invalidëve të punës me të cilin dëshmohet se konsumatori i lartpërmendur është anëtarë i shoqatës së invalidëve të punës.
Provë: Dëshmi nga shoqata e invalidëve të punës
6. Me datë 18 shtator 2007 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE
7. Me datë 21 maj 2008 DMK në ZRRE ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori dhe ka vendosur ta refuzojë konsumatorin.
Provë: Vendimi i DMK në ZRRE i datës 21 maj 2008
8. Me datë 23 qershor 2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK të ZRRE-së në Bordin e ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_87_05_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar